



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar me datë 26.04.2024 ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Dërgimin në gjykim të procedimit penal nr.09/2023, me të pandehur **Pëllumb Gjoka, Behar Brajoviq, Edmond Preka, Astmer Bilali, Ardit Hasanbegaj, Oltian Bistri dhe Xhevahir Lita.**

2. Në seancën e datës **08.11.2024** (seanca paraprake), Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Elsa Ulliri, pasi shqyrtoi pretendimet e palëve, me vendimin Nr. **77**, datë **08.11.2024**, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal Nr. 9/2023 në ngarkim të pandehurit:
 - i. **Pëllumb Kole Gjoka** i akuzuar për kryerjen e veprave penale:
 - a. “Vrasja me paramendim”, në dëm të viktimës Gj.N (B), *kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal*, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 78/2-28/4, 333/a/1 dhe 334 i K.Penal;
 - b. “Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje”, në dëm të shtetasit K.M, *kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal*, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 80-28/4, 333/a/1 dhe 334 i K.Penal;
 - c. “Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje”, në dëm të shtetasit D.D, G.T dhe I.L, *kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal*, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 80-28/4, 333/a/2 dhe 334 i K.Penal;
 - d. “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319-25 i K.Penal;
 - e. “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, *kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal*, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 278/1-28/4, 333/a/1 dhe 334 i K.Penal.

- ii. **Behar Muhamet Brajoviq** i akuzuar për kryerjen e veprave penale:
- a. “Vrasja me paramendim”, në dëm të viktimës Gj.N (B), *kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal*, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 78/2-28/4, 333/a/1 dhe 334 i K.Penal;
 - b. “Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje”, në dëm të shtetasit K.M, *kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal*, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 80-28/4, 333/a/1 dhe 334 i K.Penal;
 - c. “Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje”, në dëm të shtetasit D.D, G.T dhe I.L, *kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal*, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 80-28/4, 333/a/1 dhe 334 i K.Penal;
 - d. “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319-25 i K.Penal;
 - e. “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, *kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal*, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 278/1-28/4, 333/a/1 dhe 334 i K.Penal.
- iii. **Edmond Luigj Preka** i akuzuar për kryerjen e veprave penale:
- a. “Vrasja me paramendim”, në dëm të viktimës Gj.N (B), *kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal*, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 78/2-28/4, 333/a/2 dhe 334 i K.Penal;
 - b. “Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje”, në dëm të shtetasit K.M, *kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal*, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 80-28/4, 333/a/2 dhe 334 i K.Penal;
 - c. “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, *kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal*, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 278/1-28/4, 333/a/2 dhe 334 i K.Penal.
- iv. **Astmer Astrit Bilali** i akuzuar për kryerjen e veprave penale “Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje”, në dëm të shtetasit D.D, G.T dhe I.L, *kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal*, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 80-28/4, 333/a/2 dhe 334 i K.Penal.
- v. **Ardrit Qemal Hasanbegaj** i akuzuar për kryerjen e veprave penale “Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje”, në dëm të shtetasit D.D, G.T dhe I.L, *kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal*,

- “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 80-28/4, 333/a/2 dhe 334 i K.Penal.
- vi. **Oltian Dervish Bistri** i akuzuar për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” dhe “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete”, parashikuar nga neni 259, 287/1 dhe 295/a/2 i K.Penal.
- vii. **Xhevahir Halim Lita** i akuzuar për kryerjen e veprave penale “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete” dhe “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë” (*dy herë*), parashikuar nga neni 295/a/3 dhe 319/ç i K.Penal.
3. Dërgimin e çështjes për gjykim pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me tjetër trup gjykues, të përbërë nga tre gjyqtarë.
4. Fashikulli i gjykimit në bazë të nenit 332/ë/4 të K.Pr.Penale do të përmbajë të gjitha aktet që janë kryer gjatë hetimeve paraprake dhe që ndodhen në dosjen penale të procedimit penal Nr.9/2023 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar si dhe aktet e kryera gjatë seancës paraprake.
5. Pjesë e fashikullit të gjykimit bëhen edhe kërkesat për gjykim të shkurtuar të paraqitur nga të pandehurit.
6. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

Tiranë, më datë 08.11.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar